

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6914
E martë, 6 qershor 2023
Çmimi 0.40

Mavraj përkujton
27-vjetorin e ardhjes së
flamurit amerikan në Kosovë:
Mirënjohja nuk është dobësi,
por karakter | **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ISH-MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME, AKTUALISHT NËNKRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS, ENVER HOXHAJ, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE NË RAPORT ME ZHVILLIMET E FUNDIT NË VERI | **FAQE 3**

HOXHAJ: JEMI TË SHQETËSUAR, KOSOVA NUK KA NJË KRYEMINISTËR QË ËSHTË NË NIVEL TË DETYRËS



Politikani Enver Hoxhaj ka thënë se Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është e shqetësuar për të ardhmen e Kosovës dhe për integritetin territorial të saj për faktin se nuk po shihet një kryeministër që është në nivel të detyrës për ta udhëhequr vendin. Ai

ka thënë se situata në veri është shqetësuese pasi lëvizjet po çojnë drejt vendosjes së një protektorati në këtë pjesë duke parë prani të madhe të KFOR-it, të organizatave ndërkombëtare dhe qëndrime të përditshme të UNMIK-ut. Hoxhaj ka

theksuar se Kurti para se të vinte në qeveri ka folur për një dialog me serbët e Kosovës dhe tash po shihet se nuk ka politikë për komunitetin serb në Kosovë, nuk ka politikë as në raport me veriu dhe nuk ka politikë as në raport me dialogun

AKTUALE



REAGIM I KMDLNJ-SË: PROCESET PRIVATE NË GJYKATËN E PRIVATIZUAR SPECIALE NË HAGË | **F. 2**

TRUPA SHITESË TË NATO-S MBËRRIJNË NË KOSOVË | **F. 5**

TË ENJTEN DY SEANCA, KUVENDI SHQYRTON LIGJIN PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME | **F. 7**

EKONOMI



MTBAHET PËR HERË TË PARË 'FORUMI BIZNESOR I BORONICËS' NË KOSOVË | **F. 8**

RRITEN ÇMIMET E NAFTËS PAS ZVOGËLIMIT TË SASISË SË PRODHIMIT | **F. 8**

SPORT



GIRE SSE PUBLIKON LISTËN PËR NDESHJET E QERSHORIT | **F. 10**

EDHE QEVERIA,
EDHE SERBËT,
ME KUSHTE PËR
ZGJEDHJET | **FAQE 4-5**



KURTI ME
AMBASADORIN E
FRANCËS:
VENDOSJA E PLOTË
E SUNDIMIT TË
LIGJIT NË VERI,
E DOMOSDOSHME



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË


Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mavraj përkujton 27-vjetorin e ardhjes së flamurit amerikan në Kosovë: mirënjohja nuk është dobësi, por karakter

Publicisti Muhamet Mavraj ka përkujtuar sot 27-vjetorin e ardhjes së flamurit amerikan në Kosovë, në lagjen Arbëria (Dragodan).



“Sa datë e lehtë për t’u mbajtur në mend: 5.6.1996. Flamuri amerikan erdhi në tokën tonë, këndej gardhit, në Kosovë, në periferi të Prishtinës, në skajin e poshtëm të lagjes Arbëria (Dragodan). Banoja në periferinë tjetër, skajin diagonal të tij, lart në kodër të asaj që i thoshin Kolevicë, prej nga e shijoja thellë Prishtinën në pëllëmbë dore”, kështu e përkujton këtë datë Mavraj, derisa shpreh mirënjohje për ShBA-në, për gjithë atë që bëri për popullin e Kosovës. Ai ka theksuar se: “Tre qershora

më vonë, Kosova u çlirua, 1999, sepse ai flamur u bë aleati vendimtar i ushtrisë sonë çlirimtare. Na ndihmoi edhe në Maqedoni, edhe kudo deri sot, përfshirë edhe ngritjen e policisë dhe ushtrisë sonë shtetërore, edhe pranimin e Shqipërisë në NATO”.

Ndërkaq sot në këtë datë, Kosova ka ftohur tepër fortë raportet me ShBA-në si pasojë e situatës së fundit në veri, duke vepruar njëanshëm Qeveria e Kosovës dhe pa koordinim me aleatin e saj kryesor – ShBA-në. Amerika ka

përrjashtuar Kosovën nga ushtrimi i NATO-s “Defender Europe '23”, ka paralajmëruar se do të ndalë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar Kosovën në njohje me shtetet që nuk e kanë njohur dhe në procesin e integritimit në organizata ndërkombëtare.

“Ky qershor, i 27-ti, na gjen kështu siç po e dini, dhe s’po e zgjasim: nen ndëshkime e mosbesim të thellë. Tash po e jetojmë edhe marifetin e ri, fort të adhuruar nga armiqtë historikë, me shqiptarë gjithnjë më mosmirënjohës, haptas e qorras!”, ka shkruar Mavraj në postimin e tretë radhazi të tij për Amerikën.

Postimi i plotë i Mavrajt:

27 vjet.

Sa datë e lehtë për t’u mbajtur në mend: 5.6.1996. Flamuri amerikan erdhi në tokën tonë, këndej gardhit, në Kosovë, në periferi të Prishtinës, në skajin e poshtëm të lagjes Arbëria (Dragodan).

Banoja në periferinë tjetër, skajin diagonal të tij, lart në kodër të asaj që i thoshin Kolevicë, prej nga e shijoja thellë Prishtinën në pëllëmbë dore.

Rutina ditore e asaj vere u bë kjo: ulur në bar para shtëpizës njëdhomëshe vështroja drejt pikës së flamurit amerikan, disa kilometra larg. Për të pritur puhinë. Për ta dalluar atë flamur. Ndoshta nuk lëvizte flamuri, as era, por mendja

ime, mbase të trija bashkë. Kur binte nata, nëse me vinte keq për diçka, ishte edhe pamundësia për ta parë atë flamur.

Ai pati ardhur pasi na plasën zemrat një vere më përpara, 1995, duke dëgjuar klithmat e Bosnjës, ra Zhepa që ishte në besë të botës, ra Gorazhda, erdhi kasaphanja e Srebrenicës... dhe në Dejton natyrisht që nuk do të thirrej

zgjasim: nen ndëshkime e mosbesim të thellë. Tash po e jetojmë edhe marifetin e ri, fort të adhuruar nga armiqtë historikë, me shqiptarë gjithnjë më mosmirënjohës, haptas e qorras!

Miq, ndikoni tek tjerët, kudo që mundeni, me fjalë të buta, të matura, bindëse, se nuk bëni gjë gjynah t’i thoni dy porositë që na vijnë nga përvojat



Kosova siç na mashtronin këtu, si sport normal.

Një qershor më vonë, Kosova po gatuante nisjen, 1997. Dy qershora më vonë, amerikani viziton ushtrinë tonë në luftë. Tre qershora më vonë, Kosova u çlirua, 1999, sepse ai flamur u bë aleati vendimtar i ushtrisë sonë çlirimtare. Na ndihmoi edhe në Maqedoni, edhe kudo deri sot, përfshirë edhe ngritjen e policisë dhe ushtrisë sonë shtetërore, edhe pranimin e Shqipërisë në NATO.

Ky qershor, i 27-ti, na gjen kështu siç po e dini, dhe s’po e

njerëzore e njerëzillaku: se **MIRËNJOHJA** nuk është dobësi, nuk është turp, por është lulja më e bukur e zemrës dhe e karakterit njerëzor; se **MOSMIRENJOHËSI** është asgjë më pak sesa krijesa më e urryer, në tokë dhe në qiell, që herët a vonë do të korrë çfarë mbjellë, e nëse mbolli erë do të korrë furtunë.

Nderime kombit amerikan dhe brezave tanë atdhedashës të përvëlur në zemër, të cilët për një shekull nuk u ndalen se punuari për krijimin, ruajtjen dhe forcimin e miqësisë shqiptaro-amerikane!



Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

ISH-MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME, AKTUALISHT NËNKRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS, ENVER HOXHAJ, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE NË RAPORT ME ZHVILLIMET E FUNDIT NË VERI

Hoxhaj: Jemi të shqetësuar, Kosova nuk ka një kryeministër që është në nivel të detyrës



Politikani Enver Hoxhaj ka thënë se Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është e shqetësuar për të ardhmen e Kosovës dhe për integritetin territorial të saj për faktin se nuk po shih një kryeministër që është në nivel të detyrës për ta udhëhequr vendin. Ai ka thënë se situata në veri është shqetësuese pasi lëvizjet po çojnë drejt vendosjes së një protektorati në këtë pjesë duke parë prani të madhe të KFOR-it, të organizatave ndërkombëtare dhe qëndrime të përditshme të UNMIK-ut. Hoxhaj ka theksuar se Kurti para se të vinte në qeveri ka folur për një dialog me serbët e Kosovës dhe tash po shihet se nuk ka politikë për komunitetin serb në Kosovë, nuk ka politikë as në raport me veriun dhe nuk ka politikë as në raport me dialogun

Jam prej atyre i cili në 2007-n i ka dhënë fund punës së UNMIK-ut në Kosovë, në 2012-n i kemi dhënë fund mandatit që ka pasur ICO në mbikëqyrjen e pavarësisë së Kosovës dhe për ne është e papranueshme që të ketë situata të tilla në veri të vendit për shkak të tensioneve dhe dhunës që ka ardhur nga Serbia, që të krijohet një situatë e një protektorati të një pranie ndërkombëtare. Pra një situatë e cila do t'i demontonte interesat e Kosovës në planin afatgjatë", ka thënë Hoxhaj. Ai ka thënë se kryeministri Kurti para se të vijë në qeveri ka folur për një dialog me serbët e Kosovës dhe tash po shihet se nuk ka politikë sa i takon komunitetin serb në Kosovë, nuk ka politikë as në raport me veriun dhe nuk ka politikë as në raport me dialogun. "Prej asaj se si organizohen dhe menaxhohen zgjedhjet do të varet shumë edhe realiteti i cili do të krijohet në veri të vendit.

Shqetësimi im është se kjo çfarë ka ndodhur prej nëntorit të vitit të kaluar nga ana e z. Kurti, i cili para se të vijë në qeveri ka folur për një dialog me serbët e Kosovës dhe tash po shihet se nuk ka politikë sa i takon komunitetin serb në Kosovë, nuk ka politikë në raport me veriun dhe nuk ka as politikë në raport me dialogun, i cili është shndërruar në një instrument më tepër për t'i përmbushur interesat e Serbisë në Kosovë sesa t'i përmbushë interesat e Kosovës në Evropë", është shprehur Hoxhaj, duke shtuar se vendimi i Kurtit për targa ka qenë i gabuar, pasi u tërhoqën 2 000 veta nga institucionet në veri. Hoxhaj ka thënë se ka edhe një shqetësim. "Unë kam shqetësimin bazik, nuk e di a ka vërtet marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë pas Ohrit, pas datës 18 mars dhe pas 27 shkurtit apo është sikurse ka qenë më herët", ka deklaruar Hoxhaj.

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, aktualisht nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka folur të hënën për situatën e fundit në veri. Në një konferencë për medie në ambientet e Kuvendit të Kosovës, ai ka thënë se PDK-ja është e shqetësuar për të ardhmen e vendit, për integritetin territorial të Kosovës dhe për faktin se nuk po shih një kryeministër që

është në nivel të detyrës për ta udhëhequr vendin.

Hoxhaj duke folur për veriun, para gazetarëve ka theksuar se ai është një prej politikanëve i cili para se të dalin qëndrimet zyrtare merr vesh se çfarë po diskutohet për Kosovën. "Do të thotë, para se të dalë një deklaratë dhe para se dikush ta japë një qëndrim në raport me rrethanat në Kosovë, unë e di debatin që zhvillohet javën e fundit, dy javët e fundit apo muajin e fundit. Arsyeja pse kam reaguar në raport me qëndrimin që OSBE-ja ta ketë

një rol në mbështetje të procesit zgjedhor në Kosovë ka të bëjë jo vetëm me rolin gjatë procesit zgjedhor, por ka të bëjë me situatën që veriu po lëviz, duke shtuar praninë e madhe të KFOR-it, duke shtuar praninë e madhe të organizatave ndërkombëtare dhe duke parë çdo ditë qëndrimet e UNMIK-ut se po lëvizet drejt vendosjes së një protektorati, i cili po funksionon në terren. Kjo situatë është shqetësuese për ne si Partia Demokratike dhe është shqetësuese për mua.

Krasniqi në veri takon kryetarin e Zveçanit dhe Zubin Potokut

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka vizituar të hënën Zveçanin dhe Zubin Potokun. Ai është takuar me kryetarët e këtyre dy komunave, Ilir Pecin në fshatin Kelmend dhe Izmir Zeqirin në fshatin Çabër. "Pashë nga afër sfidat dhe vështirësitë me të cilat po

ballafaqohen jo vetëm kryetarët e komunave, por edhe qytetarët shqiptarë në këto vendbanime. Të dy kryetarët i falënderova për përkushtimin, sakrificën dhe vullnetin që, përkundër kushteve joadekuate, detyrën e tyre ta ushtrojnë me durim, përgjegjësi dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke

kontribuar në paqe dhe shtensionim të situatës në komunat e tyre. Para së gjithash, sot Izmir Zeqiri dhe Ilir Peci janë në shërbim të qytetarëve, të komunave të tyre dhe të shtetit të Kosovës. Dhe, për këtë, ata gëzojnë mbështetjen e plotë timen dhe të Partisë Demokratike të Kosovës", ka thënë Krasniqi.





Edhe qeveria, edhe serbët, me kushte për zgjedhjet

Zgjedhjet përmendën si opSION për shtensionimin e situatës, pasi marrja e detyrës nga kryetarët shqiptarë, të zgjedhur në zgjedhjet e 23 prillit, ka shkaktuar tensione dhe trazira qysh më 26 maj

Prishtinë, 5 qershor - Për mbajtjen e zgjedhjeve të reja lokale në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe - ka kushte qeveria, por edhe popullata vendase.

Zgjedhjet përmendën si opSION për shtensionimin e situatës, pasi marrja e detyrës nga kryetarët shqiptarë, të zgjedhur në zgjedhjet e 23 prillit, ka shkaktuar tensione e trazira qysh më 26 maj.

Për këtë situatë Kosova e ka fajësuar Serbinë, përkatësisht "strukturat kriminale" të organizuara prej saj, ndërsa Serbia, Kosovën. "Sundimi i ligjit është parakusht i zgjedhjeve të lira e demokratike, së bashku me fushatë zgjedhore të hapur dhe fer", thotë për "Radion Evropa e Lirë", zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu. "Grupet kriminale dhe ekstremiste duhet ose të arrestohen për sulmet e tyre, ose le të ikin në Serbi - prej nga edhe kanë ardhur jo pak prej tyre", thotë ai.

Kryeziu thotë, po ashtu, se në zgjedhjet e reja do të duhej të sigurohej pjesëmarrja e serbëve edhe si votues, edhe si

kandidatë.

Zgjedhjet e prillit janë bojkotuar nga komuniteti serb dhe përfaqësuesit e tij politikë me justifikimin se kërkesat e tyre për më shumë autonomi nuk janë përmbushur.

Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - është duke kushtëzuar sërish pjesëmarrjen në zgjedhje me tërheqjen e njësisë speciale të Policisë së Kosovës nga pjesa veriore e vendit dhe me formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë në bazë të Marrëveshjes së Brukselit. "Çështjet me prioritet që duhet të zgjidhen për ta shtensionuar situatën në terren, e që janë edhe kërkesa të serbëve në veri të 'Kosovës dhe Metohisë', janë: largimi i forcave speciale të [kryeministrit të Kosovës, Albin] Kurti nga ndërtesat komunale në veri; kryetarët e rrejshëm që nuk kanë legjitimitet dhe ligjshmëri të mos vijnë në këto objekte, sepse nuk i kanë zgjedhur qytetarët, dhe të lirohen të arrestuarit padrejtësisht, Radosh Petroviq dhe Dushan Obrenoviq", thotë për "Radion

Evropa e Lirë" nënkryetari i Listë Serbe, Igor Simiq.

Petroviq dhe Obrenoviq janë arrestuar më 29 maj, kur protestuesit serbë janë përleshur me ushtarët e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. Ata akuzohen për veprat penale: "bashkim për veprime kundërkushtetuese, me qëllim të sulmit mbi rendin kushtetues të Kosovës, rrezikim të personave nën mbrojtje ndërkombëtare" dhe për "sulm ndaj zyrtarëve".

Edhe Aleksandar Arsenijeviq, nga Iniciativa Qytetare "Mbijetesa Serbe" në Kosovë, konsideron se tërheqja e forcave speciale të Kosovës është e nevojshme përpara mbajtjes së zgjedhjeve. "Të tërhiqen forcat speciale nga veriu, t'i kthehen përgjegjësitë popullatës vendase, të fillojë formimi i Asociacionit të Komunave [me Shumicë] Serbe dhe, ngadalë dhe gradualisht, me formimin e Asociacionit, njerëzit të kthehen në institucione. Dhe, në fund, të mbahen zgjedhjet, në të cilat do të merrte pjesë Iniciativa Qytetare 'Mbijetesa Serbe'", thotë Arsenijeviq për "Radion Evropa e Lirë".

Kosova tash e dhjetë vjet refuzon ta themelojë Asociacionin me arsytimin se do të ndikonte negativisht në funksionalitetin e brendshëm

të shtetit. Pas trysnisë së vendeve ndërkombëtare, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka shpallur vizionin e tij për t'i dhënë një nivel të caktuar vetëmenaxhimi komunitetit serb, ndërsa pala serbe ka dalë, po ashtu, me draft-statutin e Asociacionit. Prishtina dhe Beogradi janë duke i vazhduar negociatat për këtë temë.

Çfarë thonë qytetarët?

Derisa nuk është e qartë se si do të veprojnë palët kundrejt kushteve të njëra-tjetrës, Sërgjani nga Mitrovica e Veriut thotë se do të merrte pjesë në zgjedhje nëse ato do të mbaheshin. "Unë do të merrja pjesë në këto zgjedhje, edhe pse nuk do t'i konsideroja si zgjedhje të rëndësishme jetike, janë zgjedhje lokale, për zgjidhjen e çështjeve teknike lokale. Natyrisht, në këtë rast do të kishte njëfarë qetësimi [të situatës]... Kusht do të ishte që serbët të siguronin njëfarë autoriteti në fushën e sigurisë", thotë Sërgjani. Ai, po ashtu, thotë se duhet të ketë kushte demokratike për mbajtjen e zgjedhjeve, pra që Beogradi të "mos ushtrojë presion" mbi qytetarët për të votuar.

Beogradi zyrtar mbështet Listën Serbe që nga formimi i saj në vitin 2013. Në çdo zgjedhje deri më tash kjo parti

ka fituar më shumë se 90 për qind të votave të serbëve. Megjithatë, vëzhgues të BE-së kanë theksuar në raportet e tyre se ajo e ka monopolizuar jetën politike të serbëve.

Edhe Bane nga Mitrovica e Veriut thotë se me shumë gjasa do të dilte në zgjedhjet lokale, por thekson se nuk ka besim tek autoritetet e Kosovës apo ato serbe. "Unë dyshoj se zgjedhjet që do të mbahen këtu do të ndryshojnë diçka. Pra, do të jetë ajo për të cilën mendoj se tashmë është rënë dakord, sikurse deri më tash", thotë Bane.

Marko do të merrte pjesë në zgjedhje vetëm nëse plotësohen kërkesat e serbëve nga veriu i Kosovës, pra nëse policia speciale tërhiqet dhe bashkëvendësit e arrestuar lirohen. "Deri më tani të gjitha zgjedhjet që janë organizuar nuk kanë qenë autoritative, kështu që mendoj se edhe këto nuk do të jenë ndonjë gjë e veçantë", thotë ky banor i Mitrovicës së Veriut.

Qëndrimin e tij se zgjedhjet e deritanishme nuk kanë qenë "autoritative" ai e shpjegon duke përmendur presionet e Listës Serbe. "Nëse njerëzit detyrohen të dalin në zgjedhje, atëherë ato zgjedhje humbasin rëndësinë e tyre, kështu që, në këtë aspekt, mendoj se përfundimisht nuk do të dilja", thotë Marko.

Trupa shtesë të NATO-s mbërrijnë në Kosovë



PRISHTINË, 5 QERSHOR - NATO ka konfirmuar të hënën se në Kosovë kanë filluar të arrijnë trupat përforcuese për misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR, pasi përleshjet e dhunshme me protestuesit në Zveçan më 29 maj i kishin lënë 30 ushtarë të KFOR-it të lënduar.

“Rreth 500 pjesëtarë të shërbimit turk nga batalioni i Brigadës 65 të Mekanizuar të Këmbësorisë së Turqisë do ta përbëjnë pjesën më të madhe të përforcimeve të NATO-s”, thuhet në deklaratën e lëshuar nga NATO-ja.

Në këtë deklaratë thuhet se këta trupa përforcues do të qëndrojnë në Kosovë për “aq sa të ketë nevojë” dhe se edhe një

batalion tjetër është vënë në gatishmëri të lartë për dislokim në Kosovë në rast nevojë.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, falënderoi Turqinë për dërgimin e trupave përforcues për misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR-in. “Turqia është një aleate e rëndësishme dhe shumë e vlerësuar, duke dhënë kontribute kyçe në NATO. Këtu përfshihen trupat për misionin tonë paqeruajtës në Kosovë, gjë që është edhe më e rëndësishme tani, kur tensionet janë të larta”, citohet t’i ketë thënë Stoltenbergu presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, më 4 qershor.

Kurti me ambasadorin e Francës: Vendosja e plotë e sundimit të ligjit në veri, e domosdoshme

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Francës në Kosovë, Olivier Guerot dhe zëvendësambasadorin gjerman në Kosovë, Matthias Conrad. Në këtë takim ata kanë diskutuar për zhvillimet e fundit në tri komunat në veri të vendit pas ditës së parë të punës së kryetarëve të rinj dhe për dhunën e shkaktuar ushtarëve të KFOR-it, policëve të Kosovës dhe gazetarëve nga grupe ekstremiste serbe. Siç njofton zyra e kryeministrit, ata janë pajtuar për rëndësinë jetike të qetësisë të situatës. “Kryeministri i njoftoi për profesionalizmin e lartë dhe integritetin e padiskutueshëm të Policisë së Kosovës në

menaxhimin e situatës pa asnjë gabim apo defekt. Vendosja e plotë e sundimit të ligjit në katër komunat në veri të Kosovës është e domosdoshme si për largimin e elementeve kriminale ashtu edhe për një fushatë të hapur dhe fer para zgjedhjeve të lira e demokratike në të ardhmen. U theksua gjithashtu nevoja për zbatimin e plotë, të shpejtë dhe pa kushte të Marrëveshjes Bazike të 27 shkurtit dhe Aneksit të saj”, ka njoftuar zyra e kryeministrit.

Kryeministri Kurti i falënderoi ambasadorin dhe zëvendësambasadorin për interesimin e vazhdueshëm të Francës dhe të Gjermanisë si dhe për kontributin e tyre.



Haxholli: Dialog me komunitetin serb në veri

Violeta Haxholli nga Instituti Demokratik i Kosovës (IDK) thotë për “Radion Evropa e Lirë” se kërkesat e Qeverisë së Kosovës janë legjitime, por se nuk mund të arrihen pa faktorin ndërkombëtar. “Kërkesa për largimin e bandave kriminale nga veriu është e arsyeshme por, në këtë drejtim, më shumë mund të

bëjë faktori ndërkombëtar, duke ushtruar presion më të madh të Beogradi që t’i tërheqë strukturat kriminale të cilat e rrezikojnë paqen atje”, thotë Haxholli.

Qeveria e Kosovës, shton ajo, duhet të ketë dialog me komunitetin serb në veri dhe përfaqësuesit e tyre politikë, për të siguruar një situatë të qetë dhe të qëndrueshme në atë pjesë të vendit. “Mesazhet që duhet të përçohen duhet të jenë pozitive, në frymën e

paqes dhe bashkëjetesës. Synim i qeverisë duhet të jetë që këtë komunitet - aq sa është e mundur - ta integrojë dhe t’i adresojë kërkesat e tij”, thotë Haxholli.

Sipas saj, zgjedhjet e prillit - me pjesëmarrje më pak se 4 për qind - nuk kanë pasur legjitimitet qytetar. “Është e palogjikshme që kjo pjesë e vendit, ku këto komuna kanë shumicë serbe, të udhëhiqen nga kryetarë shqiptarë, pasi që nuk kanë legjitimitet qytetar”, thotë Haxholli.

Pse flitet për zgjedhjet e jashtëzakonshme në veri?

Vendet perëndimore kanë propozuar organizimin e zgjedhjeve të reja për t’i qetësuar tensionet në veri të Kosovës.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se zgjedhjet e reja janë të mundshme nëse peticionin e nënshkruajnë 20 për qind e qytetarëve të regjistruar në regjistrin zgjedhor. Në bazë të ligjeve të Kosovës, në këtë mënyrë do të iniciohej procesi për shpalljen e zgjedhjeve të reja. Përveç kësaj, mundësi tjetër është nëse arrihet ndonjë pajtim më i madh politik dhe kryetarët e rinj shqiptarë, në këtë rast, japin dorëheqje.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pas bisedës me disa zyrtarë amerikanë, ka thënë se “largimi i turmave të dhunshme para ndërtesave komunale dhe zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Brukselit [për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi]

janë rruga e shtensionimit deri në zgjedhje të reja”.

Më pas, më 3 qershor, ai ka thënë se nuk mund të ketë kryetarë të rinj në katër komunat në veri pa zgjedhje të reja. Tensionet në veri të Kosovës janë rritur kur më 26 maj Policia e Kosovës ka ndihmuar kryetarët shqiptarë të komunave Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok të hyjnë në objektet komunale - gjë të cilën popullata vendase serbe e ka kundërshtuar ashpër.

Në ndërtesat e këtyre tri komunave deri më tani kanë funksionuar autoritetet e përkohshme komunale që punojnë në sistemin serb e që janë ilegale për Kosovën.

Vetëm në veri të Mitrovicës objekti i komunës është i ndarë fizikisht sipas sistemit të Kosovës dhe Serbisë dhe, për këtë arsye, atje nuk kishte protesta.

Bashkimi Evropian tha se pret që Kosova t’i ulë tensionet dhe t’i pezullojë menjëherë operacionet policore pranë ndërtesave komunale në veri të Kosovës.

16 qershori, dita më e rëndësishme në historinë e komunës së Malishevës



MALISHEVË, 5 QERSHOR - 16 qershori është dita më e rëndësishme në historinë e komunës së Malishevës, u tha në mbledhjen e rregullt të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të luftës së UÇK-së si dhe Martirëve të Luftës, e cila u drejtua nga kryesuesi, Ilaz Krasniqi. "16 qershori

është dita më e rëndësishme në historinë e komunës së Malishevës, sepse simbolizon fuqishëm Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve, prandaj në emër të anëtarëve të komitetit i urojmë të gjithë çlirimtarët dhe kategoritë e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që me

sakrificën sublimë dhanë jetën, gjymtyrët dhe gjakun për çlirim dhe lirinë e Kosovës. Ne sot nderojmë dhe me përkushtim e punë lartësojmë misionin e dëshmorëve të të gjitha brezave, me qëllimin e vetëm që ta realizojmë detyrën para bashkëkombësve dhe atdheut", ka thënë Krasniqi.

Në Obiliq projekti i rrjetit të ngrohjes qendrore po realizohet sipas planit dinamik

OBILIQ, 5 QERSHOR - Kryetari i komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, në "Facebook" i ka njoftuar qytetarët e kësaj komune për shtrirjen e rrjetit të Koogjenerimit - Ngrohjes Qendrore, projekt ky i cili po realizohet me ritëm të shpejtë. Gashi ka kërkuar mirëkuptim nga qytetarët, pasi që si rezultat i punimeve që po realizohen në këtë projekt, disa nga rrugët nuk janë të hapura për qarkullim por, sipas tij, rëndësia e jetësimit të këtij projekti është madhore. "Dinamika e shpejtë e projektit

të ngrohjes qendrore në Obiliq është tregues se jemi në rrugën e duhur drejt një të ardhme më të qëndrueshme dhe të mirë për të gjithë! Ky sukses është frymëzues për të ndjekur këtë rrugë dhe të krijohen ndryshime të mëdha për mjedisin dhe komunitetin. Nga qytetarët kërkoj mirëkuptim si rezultat i punimeve që po realizohen në këtë projekt disa nga rrugët nuk janë të hapura për qarkullim, por rëndësia e jetësimit të tij është madhor për të gjithë", ka shkruar Gashi.



Kryetari Lladrovci i bashkohet aktivitetit për një mjedis të pastër

DRENAS, 5 QERSHOR - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 5 Qershorit - Ditës Botërore të Mjedisit, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me përfaqësuesit e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, të kompanisë "Al Trade", kompanisë për Menaxhimin e Mbeturinave, duke qenë në gatishmëri si çdo ditë të vitit, iu bashkëngjitën dhe ndihmuan në aktivitete të ndryshme që promovojnë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit të pastër. "Ndër këto aktivitete veçojmë mbjelljen e drunjve dekorativë dhe të fidanëve në bashkëpunim me institucionet shkollore, bëjmë aktivitete të



pastrimit, largimin e deponive ilegale dhe të tjera. Aktivitetet u zhvilluan me qëllim të ngritjes së ndërgjegjësimit qytetar për ruajtjen e mjedisit dhe pastrimin e ambientit. Kompanitë e

menaxhimit të mbeturinave do ta vazhdojnë angazhimin e tyre maksimal për mirëmbajtjen e pastërtisë së qytetit për një mirëqenie më të mirë për qytetarë", ka njoftuar komuna e Drenasit.

Totaj: E ardhmja e Prizrenit është agjenda e gjelbër

PRIZREN, 5 QERSHOR - "Mbrojtja e mjedisit është jetike për planetin dhe shëndetin tonë", ka thënë kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit. Totaj i ka përgëzuar fëmijët për organizimin e aktiviteteve për këtë ditë si dhe ka shprehur

mirënjohje për të gjithë aktorët e përfshirë në aksionet e pastrimit të cilët e njohin rëndësinë e ambientit të pastër. "Me këto aksione përçojmë mesazh të gjithë, që bashkërisht ta ruajmë mjedisin, pasi e ardhmja e Prizrenit është agjenda e gjelbër", ka theksuar Totaj.



Nënshkruhen kontratat me 29 përfituesit e granteve në biznese dhe start-up në Skenderaj

SKENDERAJ, 5 QERSHOR - Në praninë e nënkryetarit të komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku dhe drejtoreshës për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Turizëm dhe Inovacion, Besarta Meha - Ademi, janë nënshkruar të hënën

kontratat me 29 përfituesit e granteve në biznese dhe start-up, një mbështetje kjo që ka qenë premtim i qeverisjes Nura për t'i përkrahur bizneset dhe ndërmarrësit e rinj. Nënshkryetari Lushtaku është shprehur i lumtur që

po përmbushet edhe një premtim, ndërsa ka siguruar se komuna do të vazhdojë të jetë partnere dhe mbështetëse e ideve që kanë për qëllim zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.



REAGIM I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

Proceset private në Gjykatën e privatizuar Speciale në Hagë

Prokurori i Specializuar në Gjykatën Speciale në Hagë që nga fillimi i gjykimit të Salih Mustafës, presidentit Thaçi, kryetarëve të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, si dhe shefit të GP-së të LV-së, Rexhep Selimi, si dhe të Pjetër Shalës, ka këmbëngulur që procesi i gjykimit të jetë krejtësisht i mbyllur apo proces privat në emër të mbrojtjes të dëshmitarëve sikur edhe të viktimave në kohën kur shkelë rëndë të drejtat e atyre që po gjykohen (disa edhe janë dënuar me dënime drakonike) nga kjo gjykatë jotransparente dhe me mungesë kronike të llogaridhënies. Vetëm në rastin e gjykimit ndaj Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, gjykimi ishte kryesisht publik ndonëse me redaktuar të shumta. Pas reagimit të vazhdueshëm të mbrojtjes dhe të opinionit, kryetari i trupit gjykues deklaroi se seancat private janë bërë të tepërta duke rekomanduar Prokurorin e Specializuar që të kërkojë seanca të mbyllura vetëm në raste kur atë janë të domosdoshme dhe të pashmangshme. Gjykata

Speciale në Hagë edhe deri më tani nuk ka qenë e shquar për transparencë dhe llogaridhënie duke u hapur për publikun vetëm në raste kur ka dashur ta arsyetojë dhe afirmojë (mos) punën e saj. Ndonëse deklarativisht llogaritet si pjesë e sistemit të drejtësisë kosovare (Kuvendi i Kosovës është themelues i saj), së paku, deri më tani me asgjë nuk e ka dëshmuar këtë, përkundrazi, ka qenë hermetikisht e mbyllur për institucionet e Kosovës. Vizitat e pjesëtarëve të institucioneve të Kosovës, bartës të posteve më të larta, kur vizitojnë të arrestuarit që po mbahen peng në këtë gjykatë dhe po gjykohen sipas Kodit të Hamurabit në Shtratin (Gjykatën) e Prokrustit (të Hagës), ndonëse këto vizita i bëjnë kryesisht për përfitime politike të zhveshur nga çdo ndjenjë e solidaritetit dhe përgjegjësisë institucionale, futen si vizita familjare sikur që ishte vizita e Avokatit të Popullit të Kosovës dhe të tjerë. Gjykata Speciale i raporton rregullisht UNMIK-ut por asnjëherë Kuvendit të Kosovës që paraqet nonsens për një shtet që e ka themeluar (në rrethana të terrorizimit të

deputetëve, shantazhit dhe mashtrimeve) aq më parë që të gjithë të të arrestuarit, ata që po gjykohen dhe ata që janë dënuar janë shtetas të Kosovës dhe të gjithë janë shqiptarë. Deputetët e Kuvendit të Kosovës, si themelues të kësaj Gjykate Speciale kanë dështuar që të kërkojnë transparencë dhe llogaridhënie nga kjo Gjykatë sikur që edhe të sigurojnë një monitorim të pavarur për trajtimin e të privuarve nga liria si dhe monitorim të procesit gjyqësor. Të gjithë këto që KMDLNj po i rithekson për të satën herë nuk përbëjnë ndërhyrje në punën e kësaj gjykate dhe me asgjë nuk e cenon pavarësinë e kësaj gjykate por se deputetët po tregohen të pavullnetshëm në përmbushje të mandatit që e kanë, sidomos komisionet përkatëse parlamentare; ai për Legjislacion dhe për të Drejtat e Njeriut. Përveç që kjo gjykatë po tregon mungesë të madhe të transparencës dhe llogaridhënies, metodat që po i përdorë në përpunimin e dëshmitarëve dhe sigurimin e provave, metodologjia e punës

nuk dallon me asgjë nga atë që më parë ka përdorur UDB-ja serbe dhe KOS-i (shërbimi informativ i ushtrisë). Kjo Gjykatë po angazhohet maksimalisht në korruptimin profesional të mediave që raportojnë duke trajnuar (në mënyrë selektive) media të caktuara sikur që në emër të ndjekjes së atyre që po e pengojnë drejtësinë, maksimalisht po keqpërdorin dëshmitë e dëshmitarëve, postimet në media dhe deklarimet (edhe të porositura dhe me qëllim të përfitimit) të personave të caktuar. Mjafton që akëcili dëshmitarë ta përmend emrin në seanca private të kësaj Gjykate të privatizuar dhe hetuesit e pidentifikuar (asnjëri vendas) të të bastisin dhe t'iu mbajnë peng për një kohë të gjatë. Kështu më parë kishin vepruar autoritetet reperesive serbe dhe jugosllave gjatë zbatimit të nenit të famshëm 133 (propaganda armiqësore) që ishte mundësi të keq-përdorej në përputhje me nevojat e organeve represive, deri në çastin kur u suprimua. Të njëjtin efekt dhe mundësi për keqpërdorim e ka Gjykata Speciale me nenin që

sanksionon frikësimin e dëshmitarëve (kryesisht të pa - mbrojtur) ndonëse iu kanë siguruar strehim (azil) në vendet tjera dhe ua kanë ndryshuar identitetin, për pengim të drejtësisë! Dhe, midis shumë shkeljeve të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria që po mbahen peng në Hagë e që nuk garantojnë as gjykim të drejtë, as të pavarur dhe as të pandikuar politikisht, seancat e mbyllura për publikun apo seancat private shkelin rëndë parimin e publicitetit që e përjashton publikun, qoftë për të siguruar informata reale për ecurinë e procesit, qoftë për monitorim të procesit. E tëra kjo bëhet për të mbrojtur interesat e dëshmitarëve të mbrojtur dhe viktimave që edhe për KMDLNj-në në raste të caktuara edhe është e domosdoshme mirëpo, gjithashtu është e domosdoshme të mbrohen edhe interesat e të akuzuarve përmes një procesi të drejtë gjyqësor gjithnjë duke respektuar parimin e publicitetit e që në rastin konkret, jo që nuk po respektohet por skajshmërisht po dhunohet!



Të enjten dy seanca, Kuvendi shqyrton Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme

Prishtinë, 5 qershor - Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, pas mbledhjes së Kryesisë së

Kuvendit, të hënën ka bërë me dije se të enjten do të mbahen dy seanca. "Të enjten kemi dy seanca. Në

seancën e parë nga ora 10:00 do të trajtojmë vetëm një pikë - Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme", ka thënë

Tahiri. Ai shtoi se seanca e dytë do të jetë e rregullt, e cila do të vazhdojë nga ora 11:00.



Guvernatori i BQK-së, pjesë e konferencës së FMN-së dhe Bankës Kombëtare të Kroacisë

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Ushtruesi i detyrës i guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Bashkim Nurboja, mori pjesë në konferencën e organizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, së bashku me Bankën Kombëtare të Kroacisë "Lundrimi për në të ardhmen - politikëbërja në ujërat e

rrëmuishme; nxitja e qëndrueshmërisë në Evropën Qendrore dhe Juglindore". Përveç guvernatorëve dhe ministrave të financave të 17 shteteve të ndryshme, në takim mori pjesë edhe drejtoresha ekzekutive e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Kristalina Georgieva.

Në takime, drejtoresha menaxhuese e FMN-së, Kristalina Georgieva, me guvernatorët dhe ministrat e financave të shteteve përkatëse, diskutoi lidhur me sfidat dhe mundësitë nga pasojat e fragmentimit gjeoekonomik dhe siguria energjetike, si dhe cili është roli i politikëbërjes në

adresimin e këtyre sfidave. Gjithashtu, në takim u diskutua rreth përkrahjes së FMN-së për t'i adresuar sfidat më urgjente ekonomike të shteteve, çfarë mund të bëjë më shumë FMN-ja për të ndihmuar dhe mbështetur shtetet, si dhe se si mund të shërbejnë më mirë shërbimet dhe komunikimi me

FMN-në. Gjatë konferencës, guvernatori i BQK-së, Bashkim Nurboja, ka shprehur pikëpamjet e BQK-së lidhur me fragmentimin gjeoekonomik në botë dhe sfidat e mundshme të ekonomisë së Kosovës si rezultat i zhvillimeve të tilla në ekonominë globale.



Rriten çmimet e naftës pas zvogëlimit të sasisë së prodhimit

RIAD, 5 QERSHOR - Çmimet e naftës kanë shënuar rritje të hënën pasi Arabia Saudite ka thënë se do të zvogëlojë për një milion fuçi në ditë sasisë e prodhimit përgjatë muajit korrik. Nga 10 milionë fuçi në ditë, sa i ka prodhuar në maj, ajo tani do t'i prodhojë 9 milionë fuçi. Pjesëtarë të tjerë të grupit të shteteve që prodhojnë naftë, OPEC+, janë pajtuar për zvogëlim të prodhimit për t'i stabilizuar çmimet.

Vendet e OPEC+ zotërojnë gati 40 për qind të naftës së papërpunuar, he vendimet e



tyre mund të kenë ndikim të madh në çmime të naftës.

Të hënën në Azi çmimi i naftës së papërpunuar Brent është

rritur për 2.4 për qind dhe një fuçi është shitur për 77 dollarë. OPEC+ ka thënë se synon që prodhimi të ulet në 1.4 milion fuçi në ditë prej vitit 2024. Vendimi është marrë pas një takimi shtatorësh të dielën. Çmimet e naftës janë rritur prej kur Rusia e ka nisur luftën në Ukrainë vitin e kaluar, por tani janë në nivelet e para nisjes së konfliktit. Organizata OPEC+ është pajtuar në tetor të vitit të kaluar që ta ulë prodhimin për 2 milionë fuçi në ditë, çka përbën 2 për qind të kërkesës globale.

Në prill të këtij viti grupi është pajtuar edhe për shkurtesa për tjera.

Mirëpo, zëvendëskryeministri rus, Alexander Novak, ka thënë se bisedimet e së dielës kanë çuar në "vazhdim të marrëveshjes deri në fund të vitit 2024".

Të dielën ministri saudit i Energjisë, Princi Abdulaziz bin Salman, ka thënë se zvogëlimi i sasisë së shtetit të tij për një milion fuçi në ditë mund të shtyhet edhe përtej korrikut, me qëllim të stabilizimit të tregjeve.

Mbahet për herë të parë 'Forumi Biznesor i Boronicës' në Kosovë

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Boronicat apo gurët e çmuar të botës së frutave, të njohura për përfitime të tyre të jashtëzakonshme shëndetësore, tashmë kanë nxitur rritje të kërkesës, duke i ngritur lart në tregun global. Me rritjen e kërkesës globale për këto fruta, industria e boronicës në Kosovë ka lulëzuar në një fuçi ekonomike. Kjo industri jo

vetëm që ka forcuar ekonominë e vendit, por ka krijuar edhe mundësi punësimi dhe ka nxitur praktika të qëndrueshme bujqësore.

E pikërisht për rëndësinë dhe potencialin e saj për zhvillim më të madh u organizua forumi i parë biznesor i boronicës në Kosovë që u mbajt në Prishtinë dhe në fshatin Maxhunaj të

Vushtrisë.

Në Forumin Biznesor të Boronicës në një fjalë rasti ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, tha se kultura e boronicës në Kosovë bën pjesë te frutat me më së shumti potencial për zhvillimin e bujqësisë dhe se Ministria e Bujqësisë po e mbështet këtë kulturë.



Bregu: Ky vit ka qenë më ndikuesi për Ballkanin Perëndimor sa i përket bashkëpunimit rajonal

BUDVA, 5 QERSHOR - "Ky vit ka qenë më ndikuesi për Ballkanin Perëndimor, duke shënuar pikën e shumëpritur të kthesës drejt përbashkjes së angazhimeve të marra nga qeveritë e rajonit, për krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM). Me integritet, kolegjaliteti dhe kompetencë - tre fjalë të traditës dhe sfidës - ne si KBR, së bashku me organizatat e tjera rajonale e në partneritet të ngushtë me BE u bëmë bashkë për një sfidë që ishte ndryshe nga të tjerat: Të sigurojmë një bashkëpunim rajonal gjithëpërfshirës: Bashkimin e forcave për të përforcuar edhe më tej përpjekjet rajonale", ka thënë sekretarja e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR), Majlinda Bregu, në hapjen e takimit të 15 vjetor të KBR-së në Budva.

Në nëntor 2022, në Samitin e Procesit të Berlinit, gjashtë kërret e qeverive të Ballkanit Perëndimor nënshkruan tre marrëveshjet e lëvizshmërisë, si pjesë e Lëvizshmërisë së Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM) - për Lirinë e Lëvizjes me Kartë Identifikimi, për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë, dhe për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale për Doktorë të Mjekësisë, Stomatologë dhe Arkitektë. Vetëm një muaj më



vonë, në Samitin BE-Ballkani Perëndimor të mbajtur në Tiranë, në kuadër të CRM të lehtësuar nga KBR dhe Komisioni Evropian, operatorët e telekomunikacionit nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Ballkani Perëndimor nënshkruan Deklaratën Roaming që mundëson reduktimin e tarifave të roaming-ut ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor që nga 1 tetori 2023. "Plani prej katër shtyllash i njoftuar së fundmi nga presidenti i Komisionit Evropian që synon afrimin e rajonit drejt

tregut unik të BE-së, përputhet plotësisht me përpjekjet e rajonit dhe KBR-së për të thelluar integrimin ekonomik rajonal si dhe për të pasur gjithnjë e më shumë akses në tregun e BE-së nëpërmjet politikës 'phasing in', e cila mundëson përfitime më të prekshme përpara anëtarësimit të plotë në BE, dhe kjo është për t'u vlerësuar. Koha nuk mund të ishte më e duhura, pasi tani jemi duke bërë përmbledhjen e arritjeve të Tregut të Përbashkët Rajonal si dhe po hedhim themelet për fazën tjetër të

integritit brenda Ballkanit Perëndimor si dhe me tregun e unik të BE. Ne jemi dëshmitarë ditë për ditë të zhvillimeve të cilat na rikujtojnë se bashkëpunimi rajonal nuk mund të merret si diçka e mirëqenë. Ballkani Perëndimor mund të jetë një skenë e politikave konkurruese dhe mosmarrëveshjeve, madje edhe frustrimeve, por ka një hapësirë të madhe për të vepruar së bashku, të motivuar nga një mirëkuptim i përbashkët për të përparuar - afrimi i njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe

kapitalit, flet për perspektivën inkurajuese të ndërlidhshmërisë me qëllim, dhe jo si të rastësishme", ka theksuar Bregu. Përveç sekretares së përgjithshme të RCC-së, e cili e kryesoi takimin, komisionari i BE-së për Fqinjësinë dhe Zgjerimin, Oliver Varhelyi, përcolli përmes një video-mesazhi urimin ndaj KBR-së për një vit me rezultate mbresëlënëse, duke nënvizuar angazhimin e organizatës për integrimin rajonal dhe përpjekjet në ndihmë të zbatimit të Tregut të Përbashkët Rajonal.

India kërkon hetime të reja për aksidentin vdekjeprurës me tre trena

NEW DELHI, 5 QERSHOR - Ministria indiane për Hekurudha ka rekomanduar që agjencia kryesore e detektivëve ta hetojë incidentin vdekjeprurës mes tre trenave, që la të vdekur 275 persona. Ministri për Hekurudha, Ashwini Vaishnaw, e ka bërë të ditur këtë vendim, por nuk ka dhënë më shumë hollësi. Hetimet për incidentin veçse kanë nisur dhe raportimet

preliminare tregojnë se një defekt në sinjal ka çuar në përplasje. Përplasja e tre trenave në mbrëmjen e së premtes, është përshkruar si aksidenti më i rëndë me trena në Indi, këtë shekull. Më shumë se 1 000 persona janë plagosur dhe janë dërguar në spitale. Disa familje janë ende në kërkim të të dashurve të tyre. Ende nuk është e qartë se pse Bordi Hekurudhor, trupi kryesor i

ministrisë për vendimmarrje, ka rekomanduar hetime të ndara nga Byroja Qendrore e Hetimeve, kur hetimet veçse kanë nisur. Kjo Byro heton raste të krimin të nivelit të lartë, duke përfshirë mashtrime serioze financiare dhe vrasje. India e ka një prej rrjeteve më të mëdha hekurudhore në botë, dhe miliona pasagjerë e përdorin atë në baza ditore. Megjithatë, një pjesë e mirë e linjave kanë nevojë për riparime.



Inflacioni në Turqi, nën 40 për qind për herë të parë këtë vit



STAMBOLL, 5 QERSHOR - Inflacioni vjetor në Turqi ka rënë nën shifrën 40 për qind në maj, për herë të parë që 16 muaj. Sipas të dhënave zyrtare, kjo ulje është nxitur nga oferta momentale e gazit falas për ekonomitë familjare. Çmimet e konsumit janë rritur për 39.6 për qind në baza vjetore dhe kanë qenë pothuajse stabile me muajin paraprak, ka thënë Agjencia shtetërore e Statistikave. Megjithatë, këto shifra zyrtare të parat prej kur presidenti turk, Rexhep Tajip Erdogan, është betuar si president për një mandatë të ri më 28 majjanë duke u sfiduar nga ekonomistët e

pavarur të Grupit Kërkimor për Inflacion në Turqi. Sipas këtij grupi, norma vjetore e inflacionit shkon mes 105 deri më 109 për qind, varësisht nëse merret parasysh ofrimi falas i gazit. Erdogani, i cili e ka nisur mandatin e tretë si president, ka thënë se luftimi i inflacionit do të jetë prioriteti i tij kryesor. Inflacioni pati prekur shifrën 85 për qind, në vjeshtën e vitit 2022, para se të niste rënia më vonë. Ndonëse çmimet vazhdojnë të rriten çdo muaj, trendi është shumë më i ngadalshëm sesa në vitin paraprak.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Muja: U rrita në rrugët e Kosovës, punova shumë për këtë ditë

ANTWERP, 5 QERSHOR - Futbollisti nga Kosova, Arbnor Muja, është shpallur kampion me Antwerpen në Belgjikë, në sezonin e tij të parë me këtë skuadër. Pas suksesit të arritur, Muja ka shprehur emocionet e tij të mëdha përmes një postimi në "Facebook", duke

përshkruar rrugëtimin e tij deri te ky sukses. "Mes këtyre dy fotove ka shumë vite, por edhe shumë emocione. Dua ta ndajë me ju momentin më të madh të karrierës sime duke e bashkangjitur me një kujtim nga shkolla fillore. U rrita në rrugët e Kosovës, duke luajtur

futboll me shokët e lagjes, jetoja vetëm me një qëllim, të bëhem futbollist profesionist, të luaj në arenën ndërkombëtare, të jem sikur ata në televizion, por të jem kampion në një shtet evropian, se kam menduar kurrë. Çdo ditë punova fort dhe besova edhe pse shumë herë u

theva nga pikëllimi. Se plani i Zotit është më i miri për ju, e dëshmoja me karrierën time", ka shkruar Muja. "Të gjithë ju që më përkrahët, ju faleminderit! Faleminderit familjarëve, shokëve, juve sportdashës, të gjithëve! Dhe për fund, dua ta falënderoj



veten! Faleminderit Arbnor që nuk e lejove veten të mposhtesh kurrë!", ka shtuar Muja.

Giresse publikon listën për ndeshjet e qershorit



Prishtinë, 5 qershor (ER) - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll këtë muaj do t'i zhvillojë dy ndeshje kualifikuese për "Euro 2024". "Dardanët" më 16 qershor e presin në stadiumin "Fadil Vokrri" Rumaninë, derisa tri ditë më pas luajnë kundër Bjellorusisë. Përzgjedhësi Alain Giresse ka publikuar listën e futbollistëve për këto dy ndeshje. Në listën e strategut francez nuk mungojnë risitë. Për herë të parë janë ftuar sulmuesit Jetmir Topalli dhe Ermal Krasniqi.

Kosova ndodhet në Grupin I në kualifikimet për "Euro 2024". Pas dy ndeshjeve të para ka vetëm dy pikë dhe synon ta marrë fitoren e parë. Çuditërisht në listë nuk ndodhet Arbnor Muja që ka shkëlqyer me Antwerpen në elitën e futbollit belg, duke fituar titullin e kampionit dhe Kupën e Belgjikës. Në listë nga grumbullimi i fundit nuk janë përfshirë Florent Hadergjonaj, Zymer Bytyqi, Valon Berisha dhe Albion Rrahmani i Ballkanit.

Lista e futbollistëve:

Arjanet Muriq, Samir Ujkani, Visar Bekaj, Mërgim Vojvoda, Amir Rrahmani, Lirim Kastrati, Mirlind Kryeziu, Fidan Aliti, Amar Gërxhaliu, Leart Paqarada, Betim Fazliji, Donat Rudhani, Ibrahim Dreshëviq, Hkeuran Kryeziu, Bersant Celina, Florian Loshaj, Elbasan Rashani, Flomet Muslija, Edon Zhegrova, Milot Rashica, Jetmir Topalli, Ermal Krasniqi, Vedat Muriqi.

Arben Krasniqi, pjesëmarrës në Konventën e Mini Basketbollit në Madrid

MADRID, 5 QERSHOR - Në Madrid të Spanjës është mbajtur Konventa e Mini Basketbollit, në të cilën ka marrë pjesë edhe drejtori teknik në Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Krasniqi. Konventa, që është mbajtur nga 2 deri më 4 qershor, ishte pjesë përmbyllëse e trajnimit të kursit për trajnerë të Mini Basketbollit 2022/23 të organizuar nga FIBA Europe dhe me përfundimin e suksesshëm të këtij kursi zgjedhen edhe instruktorët nacionalë të Mini Basketbollit nëpër federatat përkatëse. Në këtë konventë, ndër të tjera, është diskutuar për: Metodologjinë e Mësimdhënies dhe Mësimin të Trajnerëve/Efektive, Kurrikula e ecurisë së mësimdhënies, Mësimet për taktikat në grup-sulm dhe mbrojtje. Qëllimi i këtij kursi ka qenë që



trajnerët të jenë në gjendje të punojnë me fëmijët si dhe ndarja e njohurive të fituara në këtë klinikë me trajnerët e tjerë të cilët mund të kontribuojnë për Mini Basketbollin. Mini Basketbolli është duke shënuar rritje të jashtëzakonshme dhe

FIBA Europe ka cilësuar se federatat kanë nevojë për më shumë trajnerë të Mini Basketbollit, të cilët janë në gjendje ta ofrojnë mjedisin e nevojshëm për fëmijët, duke mësuar se si të luajnë lojën e basketbollit.

Prishtina fiton Kupën e Kosovës

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Prishtina e ka fituar Kupën e Kosovës në futboll, pasi të hënën në mbrëmje, ka shënuar fitore në ndeshjen finale kundër Gjilanit, me rezultat 2:0, që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri". Kësajori, klubi bardhekaltër e ka kthyer këtë trofe në kryeqytet pas tre vjetësh. Përballja e këtyre dy skuadrave solli lojë të baraspeshuar, por prishtinasit arritën të jenë më kreativ në fazën sulmuese, duke i kapitalizuar rastet e tyre në gola në pjesën e dytë. Rezultatit e zhbllokoj Genc Hamiti, me golin e shënuar në minutën e 68-të, me një guajtje të fortë,

pas asistimit të Mërgim Pefqelit. E ky i fundit e vulosi më pas fitoren e Prishtinës në minutën e 76-të, me një supergol nga 25 metra. Në minutat e mbetura gjilanasit u përpoqën të ndryshojnë fatin e kësaj ndeshje, por edhe pse e gjetën golin në minutën e 87-të përmes Mevlan Zekës, ai më pas u anulua me ndërhyrjen e VAR-it për shkak të pozitës jashtë loje. Në fund, medaljet për ekipet finaliste dhe trofeun për kapitenin e Prishtinës, Gledi Mici i ndanë kryeministri Albin Kurti dhe presidenti i FFK-së, Agim Ademi. Për Prishtinën ky është trofeu i tetë në këtë garë.



Dragusha emërohet trajner i "Ramiz Sadiku"-t

PRISHTINË, 5 QERSHOR - KF "Ramiz Sadiku" e ka emëruar Alban Dragushën në pozitën e trajnerit. Marrëveshja e nënshkruar mes ish-lojtarit të dëshmuar dhe skuadrës nga

Prishtina është dyvjeçare, ndërsa Ramiz Sadiku ka njoftuar se shumë shpejt do të emërohen edhe trajnerët e tjerë. "Alban Dragusha emërohet kryetrajner i ekipit të

parë të KF Ramiz Sadiku. Në ambientet e KF Ramiz Sadiku u nënshkrua marrëveshja dyvjeçare me trajnerin e njohur Alban Dragusha për stinoret 2023/24 dhe 2024/25.

Së shpejti pritet edhe kompletimi i stafit të trajnerëve të cilët do të punojnë me kryetarjnerin. Stinori i ri me shumë risi", ka njoftuar KF Ramiz Sadiku.



Vendi i dytë në Spanjë trimëron Hamiltonin: Tani radhën e ka fitorja

BARCELONË, 5 QERSHOR - Vendi i dytë që Lewis Hamilton arriti të dielën në garën e Spanjës ka rikthyer optimizmin te piloti britanik. Shtatë herë kampioni i botës në Formula 1 ka mbetur i kënaqur nga paraqitja e makinës Mercedes, që në këtë garë ishte

forca e dytë pas Red Bull, duke lënë pas Aston Martin e Ferrarin. "Jemi të kënaqur nga rezultati. Natyrisht që fitorja është objektivi kryesor, por ishim dy pilotë të Mercedes në podium (Russell u rendit i tretë). Duket se risitë që kemi sjellë dhanë rezultatin e

duhur, sidomos pas sa i përket degradimit të gomave, pasi i menaxhuam ato më mirë", ka thënë Hamilton. "Jemi para Aston Martin dhe kjo ishte një surprizë për ne, pasi tregon se jemi në rrugën e duhur për sa i përket zhvillimit të makinës.

Shohim më në fund pakëz dritë në fund të tunelit, por duhet ende punë për të shkuar sa më shpejt aty", ka deklaruar Hamilton, që mori 18 pikë që e ngjithin në vendin e katërt të renditjes për pilotë, pas Verstappen, Perez e Alonso.



Sylvinho: Dëshira për fitore është e madhe

Tiranë, 5 qershor - Në prag të ndeshjeve të qershorit, ajo me Moldavinë dhe Ishujve Faroe, trajneri i kombëtares shqiptare, braziliani Sylvinho, ka dalë në konferencë për shtyp. Tekniku brazilian gjithashtu është ndalur edhe te lista e lojtarëve të grumbulluar. Sylvinho gjithashtu ka thënë se ndodhen në një moment delikat dhe kjo pasi gjendja fizike e lojtarëve është e ngarkuar pasi kampionatet me klubet përkatëse sapo kanë përfunduar. "Sigurisht që kemi moment delikat sepse është fund sezoni dhe lojtarët janë të ngarkuar. Kjo është pjesë e punës dhe kam folur e kam takuar shumë lojtarë. Është situatë ku grupi duhet menaxhuar sa më mirë. Duhet menaxhuar intensiteti që lojtarit të japë 100% në fushë dhe prandaj kemi zgjedhur 26 lojtarë. Duhet menaxhim i mirë pasi kemi moment delikat. I kemi të gjitha mundësitë për të fituar këtë ndeshje, por fusha do e tregojë më mirë këtë gjë. Ne kemi një rrugë për të bërë dhe të gjitha ndeshjet duhen fituar, të marrim pikë. Gjithsesi në këtë moment që flasim, unë e kam mendjen vetëm te ndeshja ndaj Moldavisë. Ne kemi një ekip të mirë, jam i kënaqur me punën", ka thënë Sylvinho. "Duhet të bëjmë një lojë të mirë, rezultati nuk është një gjë që ne



mund ta kontrollojmë. E rëndësishme është të marrim pikë nga çdo ndeshje, sa më shumë aq më mirë. Dëshira është e madhe për të shkuar në finale të Euro 2024'. Jam i bindur që debutimi im në shtëpinë tonë do të jetë emocionues dhe që tifozët tanë do të na mbështesin për të marrë tre pikët. Këtë herë kemi një tjetër grumbullim lojtarësh në krahasim me atë ndaj Polonisë", ka shtuar Sylvinho. "Sadiku dhe Muçi? Kemi një grumbullim ndryshe këtë herë. Përpara kemi dy ndeshje, kundërshtarë krejt ndryshe nga Polonia. Muçi vjen nga një formë mjaftë e mirë, emeriton që të jetë këtu me ne dhe të ndihmojë skuadrën. Me Sadikun kam folur më përpara. Ai kthehet këtu pas gati tre vitesh. Është një simbol për Kombëtaren. Është një

lojtarë që e njih mjaft mirë zonën, golin. Është e rëndësishme që ne të bëjmë një lojë të bukur, por në fund do të vlejnjë tre pikët. Ne e dimë që na duhen këto tre pikët. Ndeshja nuk fitohet nga një çast, por nga ajo që ndërton. Mund të them që jam i kënaqur nga kjo listë. Të gjithë ata që janë këtu e meritojnë. Është e rëndësishme të fitojmë me Moldavinë. Çekia nuk ka asnjë humbje. Është situatë shumë e tendosur. Gjithsesi jam i bindur për lojtarët e mi. Ata që do të zbresin në fushë do të jenë ata që do të jenë në 100%. Është sa më e rëndësishme që të bëjmë një lojë sa më të mirë përpara tifozëve tanë", është përgjigjur Sylvinho. "Roshi? Patjetër që Roshi është një lojtar i rëndësishëm. Nuk do të thotë që nuk do të jetë me ne në shtator. Është një lojtar mjaft i aftë. Por në këto momente kemi dhe lojtarët të tjerë që mund ta bëjnë më mirë atë rol. Roshi është në monitorim, ashtu si shumë lojtarë të tjerë të Kombëtares. Ne duhet të mendojmë për të fituar me Moldavinë e pastaj për ndeshjet e tjera. Gjithsesi unë jam i bindur për lojtarët e mi, e di që lojtarët e mi që do të zbresin në fushë do të japin 100% nga vetja e tyre", është shprehur trajneri i kombëtares shqiptare.

Miami barazon serinë e finaleve me Denverin

MIAMI, 5 QERSHOR - Vizion spektakli në finale të "play-off"-it për titullin kampion në NBA. Miami Heat barazoi 1-1 serinë e ndeshjeve finale ndaj Denver Nuggetsit pas fitores me rezultat 111-108 arritur jashtë fushës. Një ndeshje spektakolare, e hapur dhe me rivalitet deri në fund, me miqtë që bënë një përmbysje fantastike në periodën e fundit, duke treguar se janë ende "gjallë". Ekipi nga Florida e nisi mirë, duke krijuar 9 pikë diferencë, por më pas vendosit përmbysjen dhe morën frenat e lojës në dorë, megjithatë nuk arritën në fund ta mbanin avantazhin minimal. Denveri nuk arriti të shfrytëzojë si duhet faktorin fushë, duke gabuar në fundin e sfidës. Nikola Jokic realizoi 41 pikë e



11 rebounde për Denverin, por që s'mjaftuan për ta shmangur humbjen, pasi nuk u mbështet ashtu si duhet nga pjesa tjetër e skuadrës. Në kahun tjetër Miami pati tre lojtarë që realizuan mbi 20 pikë, që tregon se kolektiviteti bëri dallimin në parket. Vincent realizoi

23 pikë, mbështetur edhe nga Butleri e Adebayo me nga 21 pikë secili. Vendimtare pikët e Robinsonit në fundin e takimit, që sollën përmbysjen e madhe të skuadrës së Miamit, që tashmë do të luajë në fushën e saj dy sfidat e radhës, duke nisur nga 7 qershori.

SHKURT

Babai i Messit pas takimit me Laportan: Leo dëshiron të rikthehet te Barça

"Messi dëshiron të rikthehet te Barcelona". Kjo ishte deklarata e babait të Messit, Jorge Messi pas takimit që pati sot me presidentin e Barcelonës, Joan Laportan. Dyshja u takuan të hënën pasi La Liga ia pranoi planin e qëndrueshmërisë Barcelonës. "Leo dëshiron të rikthehet dhe unë dua ta shoh atë te Barcelona. Rikthimi te Barcelona është me siguri një opsion", u shpreh Jorge Messi pas takimit me Laportan.

Ancelotti: 100 % do të jem trajner i Realit

Realit i Madridit e mbylli me barazim dhe tashmë do t'i shijojë pushimet përpara se të mendojë për sezonin e ardhshëm. Kryefjalë te madrilenët gjithashtu ka qenë Carlo Ancelotti, i cili u përfol për një kalim të mundshëm te Brazili. Gjithsesi ai ka zgjedhur ta konfirmojë vetë të ardhmen e tij në intervistën pas ndeshjes, duke u shprehur se do të jetë pjesë e Realit. "Unë do të qëndroj te Realit i Madridit. Është 100 % e sigurt", ka thënë Ancelotti.

Osimhen: E dua Napolin dhe nuk e kam problem të qëndroj

Sulmuesi i Napolit, Victor Osimhen, ka folur për të ardhmen e tij. 24-vjeçari ishte golashënuesi më i mirë i Serisë A dhe u votua gjithashtu si sulmuesi më i mirë i ligës dhe e ndihmoi Napolin ta fitonte "Scudetto" pas 33 vjetësh. "Kemi pasur një sezon fenomenal. Fitimi i kampionatit italian është arritja kryesore në karrierën time për momentin. Jam krenar për gjithçka që kam arritur, por nuk do të ndalem me kaq. E ardhmja ime? I takon presidentit të klubit. Unë e dua Napolin. Jam shumë i vlerësuar këtu. Nuk e kam problem të qëndroj, por varet nga presidenti ynë, jo nga unë", ka thënë Osimhen.

Benzema arrin marrëveshje me Al-Ittihadin

Sulmuesi Karim Benzema raportohet se ka arritur marrëveshje me klubin nga Arabia Saudite, Al-Ittihad. Ishte eksperti i transferimeve, Fabrizio Romano, që raporton se tashmë marrëveshja mes dy palëve është arritur. Sulmuesi francez do ta vazhdojë karrierën në Saudi Pro League, ku do t'i bashkohet kampionit Al-Ittihad. Benzema të dielën u zyrtarizua se nuk do të vazhdojë me Realin, ku kishte korrur suksese të jashtëzakonshme. Te Al-Ittihad Benzema raportohet se do të përfitojë rreth 100 milionë euro në vit, plus disa përfitime të tjera.

Realit, gati 100 milionë sterlina për Kanen

Karim Benzema e ka zyrtarizuar largimin nga Real Madridi, derisa në Angli vijojnë të insistojnë

se sulmuesi aktual i Tottenham Hotspurit, Harry Kane, është emri i parë në listën e Perezit.

Sipas "Daily Star", Realit po përgatitet një ofertë prej 100 milionë sterlinash për ta bindur Tottenhamin ta

lë të lirë kapitenin e përfaqësueses angleze. Kane është pjesë e "Spurs"-it nga viti 2009,

por ka qenë i huazuar edhe në klubet si Leyton Orient, Millwall, Norwich City dhe Leicester City.



Bazuar në nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Paneli për përzgjedhjen e Guvernatorit/es të Bankës Qendrore publikon:

Shpallje

Për plotësimin e pozitës së Guvernatorit/es të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Profili i kërkuar i kandidatit/es:

- Të jetë shtetas/e i/e Kosovës;
- Të jetë me integritet;
- Të ketë përgatitje universitare në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështje juridike;
- Të ketë minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështje juridike;
- Të ketë njohuri në zhvillimin dhe implementimin e politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Të ketë përvojë dhe aftësi menaxheriale;
- Të përmbushë kërkesat nga neni 40 i Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Dokumentet e kërkuara për pozitën në fjalë:

- CV;
- Letër motivuese;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e ID-së;
- Kopjet e diplomave (të noterizuara), ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/nostrifikuara zyrtarisht nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Certifikatën nga Gjykata kompetente, e cila dëshmon se kandidati/ja nuk ka qenë asnjëherë subjekt i ndonjë vepre penale (certifikatë kjo jo më e vjetër se 3 muaj); dhe
- Vërtetimin nga Policia që dëshmon se kandidati/ja nuk është nën hetime (vërtetim ky jo më i vjetër se 3 muaj).
- Certifikatat profesionale, rekomandimet dhe referencat e mundshme (opsionale).

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të përzgjedhë një individ. Miratimi dhe emërimi për këtë pozitë do të bëhet nga Presidenti/ja i/e Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84.27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38.2 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e lartcekur përmes email adresës vijuese: paneli@bqk-kos.org

Emrat e kandidatëve të cilët Paneli i dërgon në Kuvendin e Kosovës dhe Qeveri (për t'u përzgjedhur) do të publikohen në faqen zyrtare të Bankës Qendrore. Me aplikimin për pozitën e Guvernatorit/es, konsiderohet se kandidati/ja ka dhënë pëlqimin për publikimet në fjalë.

Afati i fundit për aplikim është **21 qershor 2023**.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e Panelit do të ftohen për intervistë.



Na osnovu člana 38. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo, Komisija za izbor Guvernera/Guvernerke Centralne banke objavljuje:

Oglas

Za popunjavanje pozicije Guvernera/Guvernerke Centralne banke Republike Kosovo.

Zahtevani profil kandidata/kandidatkinje:

- Da bude državljanin/državljanica Kosova;
- Da bude sa integritetom;
- Da ima univerzitetsku spremu u oblastima ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Da ima najmanje deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblastima ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Da ima znanje u razvoju i sprovođenju važnih politika u vezi sa misijom, ciljevima i zadacima CBK-a;
- Da ima iskustvo i menadžerske veštine;
- Da ispunji uslova iz člana 40. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo;
- Poznavanje engleskog i drugih jezika je prednost.

Dokumenti potrebnii za predmetnu poziciju:

- CV;
- Motivaciono pismo;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte;
- Kopije diploma (notarizovane), dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane Ministarstva obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacija;
- Dokaz o radnom iskustvu (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte o zaštiti ličnih podataka);
- Sertifikat nadležnog suda kojim se dokazuje da kandidat/kandidatkinja nikada nije bio predmet nekog krivičnog dela (ovaj sertifikat da ne bude stariji od 3 meseca); i
- Potvrda od Policije kojom se dokazuje da kandidat/kandidatkinja nije pod istragom (ova potvrda da ne bude stariji od 3 meseca).
- Profesionalni sertifikati, preporuke i moguće reference (opciono).

Imenovanje će biti na mandat od pet godina počevši od dana imenovanja.

Lista kandidata kvalifikovanih od strane Komisije biće poslata Skupštini Republike Kosovo, koja će izabrati jednog pojedinca. Odobrenje i imenovanje za ovu poziciju izvršiće predsednik/ca Republike Kosovo u skladu sa članom 84.27 Ustava Republike Kosovo i članom 38.2. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo.

Zainteresovani kandidati treba da dostave gorenavedenu dokumentaciju putem e-maila na sledeću adresu: paneli@bqk-kos.org

Imena kandidata koje Komisija šalje u Skupštini Kosova i Vladi (da budu odabrani) biće objavljena na internet stranici Centralne banke. Uz prijavu za poziciju Guvernera/Guvernerke smatra se da je kandidat/kandidatkinja dao saglasnost na predmetne publikacije.

Krajnji rok za prijavu je **21. juna 2023. godine**.

Na intervju će biti pozvani samo kandidati koje odabere Komisija.

Hortikultura

"HORTIKULTURA" SH.A.
Nr. 1233
Dt. 06.06.2023
PR:IT/13

Në bazë të nenit 8, të Ligjit të Punës nr.03/L-2012, NPL "Hortikultura shpall këtë:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës

Titulli: Konsulent/e i/e jashtëm/e për projekt në ri-organizimin e njësisë së lulishtes

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv
Orët e punës: 40 orë në javë
Kompensimi: 800 euro (bruto) në muaj

Kohëzgjatja e kontratës: për kohë të caktuar
Detyrat dhe përgjegjësitë:

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale:

- shkollim superior në degën e Arkitekturës apo Ndërtimtarisë, Arkitekturë Peizazhi apo Inxhinieri Mjedisore
- të ketë përvojë në menaxhimin dhe realizimin e projekteve
- njohja e softwareve dhe programeve Archicad, Autocad, Photoshop
- aftësi për punë ekipore
- aftësi të shprehura komunikimi
- të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë
- e preferuar njohja e gjuhës angleze
- përvojë 5 vjeçare

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë:

- analizon, vlerëson situatën ekzistuese të njësisë së lulishtes
- bën studim fizibiliteti për projektin e propozuar
- bën vlerësimin e paramasës dhe parallogarisë
- jep sygjërimet për gjendjen faktike të terrenit
- koordinon vazhdimisht me njësinë e lulishtes për të identifikuar nevojat
- përcjell vegetacionin e disponueshëm në tërësi dhe propozon në rregullimin e dizajnit-pamjes së vegetacionit, duke përfshirë mbjelljen e luleve, mbjelljen e materialit dendrologjik, krasitjen e drunjeve dekorativ dhe punë të ngjashme në gjelbërim
- analizon praktikën dhe proceduarat e punës me qëllim të rritjes së efikasitetit si dhe propozon modifikimin apo përshtatjen e tyre sipas nevojës dhe zhvillimit
- përgatit planin e të hyrave dhe shpenzimeve vjetore
- përgatit planet afat-mesme dhe afatgjate të njësisë së lulishtes
- për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv

Procedura e konkurimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrat e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes NPL "Hortikultura" apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën www.hortikultura-pr.com.

Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën, rr. Tahir Zajmi, pn në Prishtinë, apo përmes Postës së Kosovës.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

Aplikacionit duhet bashkëgjatë:

- formulari për aplikim i NPL "Hortikultura";
- dëshmitë për kualifikimin shkollor;
- dëshmitë për përvojën e punës;
- kopjen e letërnjoftimit
- certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është i/e dënuar (jo më të vjetër se gjashtë muaj)

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë Brenda dy ditësh (2) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.

Shpallja është e hapur që nga data 06.06.2023 – 26.06.2023

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të NPL "Hortikultura".

Hortikultura

"HORTIKULTURA" SH.A.
Nr. 1233
Dt. 06.06.2023
PR:IT/13

Na osnovu Zakona o Radu br.03/L-2012, Plan 8, JLP "Hortikultura objavljuje:

KONKURS
Da popuni radno mesto

Zvanje: Vanjski konsultant za projekat reorganizacije cvečara

Izveštava: Glavnom Izvršnom Direktor
Radno vreme: 40 sati nedeljno
Naknada: 800 eura (bruto) mesečno

Trajanje ugovora: na određeno vreme

Kvalifikacije i stručna obuka:

- visoko obrazovanje u oblasti arhitekture ili građevinarstva, pejzažne arhitekture ili inženjerstva zaštite životne sredine
- ima iskustvo u upravljanju i implementaciji projekata
- poznavanje softvera i programa Archicad, Autocad, Photoshop
- veštine timskog rada
- jake komunikacijske veštine
- ima radnu etiku i visok integritet
- poželjno je znanje engleskog jezika
- 5 godina iskustva

Dužnosti i odgovornosti:

- analizira, ocenjuje postojeće stanje jedinice cvečara
- izrađuje studiju izvodljivosti za predloženi projekat
- ocenjuje prethodno merenje i predračun
- daje savete o stvarnom stanju terena
- stalno koordinira sa jedinicom radi identifikovanja potreba
- prati raspoloživu vegetaciju u celini i predlaže uređenje projektantskog prikaza vegetacije, uključujući sadnju cveča, sadnju dendrološkog materijala, orezivanje ukrasnog drveća i slične radove u zelenilu
- analizira radne prakse i procedure u cilju povećanja efikasnosti i predlaže njihovu modifikaciju ili prilagodavanje prema potrebama i razvoju
- priprema godišnji plan prihoda i rashoda
- priprema srednjoročne i dugoročne planove jedinice
- za svoj rad odgovara Glavnom Izvršnom Direktor

Konkursna procedura

Službeni formular zainteresovani kandidati mogu preuzeti u Službi za ljudske resurse Preduzeća "Hortikultura" ili ga preuzeti sa web stranice www.hortikultura-pr.com.

Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji Sektoru za ljudske resurse na adresu ul. Tahir Zajmi, bb u Prištini, ili preko Pošte Kosova.

Kandidati koji konkurišu moraju uneti tačnu adresu, kontakt telefon i email adresu.

Na intervju će biti pozvani samo odabrani kandidati.

Uz prijavu se mora priložiti:

- obrazac prijave od JLP "Hortikultura";
- uverenja o školskoj spremi;
- dokaz o radnom iskustvu;
- kopiju lične karte
- uverenje suda kojim se dokazuje da nije osuđivan (ne starije od šest meseci)

Napomena: Prijave poslate poštom, na kojima se nalazi poštanski žig na pošiljci upucenoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete u obzir ako stignu u roku od dva (2) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one nepotpune sa relevantnom dokumentacijom neće se razmatrati.

Nepotpune prijave i dokumentacija u skladu sa zahtevima navedenim u ovom oglasu, kao i oni koji pristignu nakon navedenog roka, neće se razmatrati.

Oglas je otvoren od 06.06.2023 – 26.06.2023.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Odjeljenju za ljudske resurse JLP "Hortikultura".



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook




www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arjeta Gjoshi shpall të pavlefshme dëftesat e Gjmnazit: Gjergj Kastrioti "Skënderbeu" drejtimi Shkenca Natyrore kl. 10,11,12.

- Ilir Sadrijaj nga Gramaçeli, komuna e Deçanit shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" instalues i ujit dhe kanalizimit Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Makinerisë Gjakovë.

- Valon Vala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Irfan Gerbani shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.

- Edin Bicaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Visar Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

- Enver Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIIIshfmu "Fadil Hisari" Prizren.

- CelebicEsef shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- XhelalFerizi shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.

- Valmir Kadrija shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

- Veton Aliu, shpall te pavlefshme dëftesën e 11 klase te shkollës se mesme "ARKITEKT SINANI".

- Bleona Binaku, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "FRANG BARDHI".

- Merlind Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. III të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Remzi Kida nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 11 të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Flamur Godeni nga Gajkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

